



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

---

**MENDIM I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË  
CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS CURIAE)**

**drejtuar**

**Gjykatës Themelore në Prishtinë**

**lidhur me**

*procesin gjyqësor C.nr 6728/21 të iniciuar nga znj. Xhyldane Kiçmari*

**A.nr. 30/2022**

Drejtuar : Znj. Albina Shabani Rama, kryetare  
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 19 shtator 2022

## Qëllimi

1. Ky mendim i Avokatit të Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës, ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, përkatësisht kriteret që duhet të plotësohen sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike (në tekstin e mëtejme: Ligji për Energjinë Elektrike), për shkarkimin e anëtarit të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

## Përmbledhja e fakteve

2. Avokati i Populli, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë nga znj. Xhyldane Kiçmari (në tekstin e mëtejme: ankuesja), parashtruar kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me vendimin për shkarkimin e saj nga pozita e anëtares së Bordit të Drejtorëve të NP KOSTT Sh.A.
3. Sipas informatave të ofruara nga ankuesja kuptohet se ajo me Vendimin nr. 07-V-083, i datës 29 tetor 2020, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ishte zgjedhur anëtare e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike “Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut” (KOSTT). Ankuesja po ashtu ka njoftuar se ajo është drejtoreshë e Njësisë së Auditimit në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror (AShNA).
4. Më tej ankuesja ka njoftuar se duke pasur parasysh faktin se i mban dy pozita, ajo i ishte drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: AKK) me kërkesë për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit.
5. Përkitazi me këtë çështje, AKK-ja më 28 korrik 2021 e kishte njoftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës se ankuesja mund ta mbante pozitën e anëtares së Bordit të KOSTT-it, mirëpo nuk mund ta realizonte pagën sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 05-V-389, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
6. Lidhur me këtë çështje, ankuesja kishte njoftuar se i ishte drejtuar me kërkesë Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti që ta shqyrtonte çështjen e pagës së saj si anëtare e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it dhe ta përcaktonte kompensimin për ushtrimin e funksionit në fjalë.
7. Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2021, kishte nxjerrë përfundim sipas të cilit ankueses i kërkohej që të përcaktohej se cilën pozitë dëshironte ta ushtronte.
8. Më tej Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare e mbajtur më 12 gusht 2021, kishte nxjerrë Vendim nr. 08-V-063, me të cilin ankuesja ishte shkarkuar nga pozita e anëtares së Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it.
9. Ankuesja kishte njoftuar se më 3 shtator 2021 kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me pretendimin se vendimi për shkarkimin e saj ishte i kundërligjshëm, sepse nuk ishin përmbushur kriteret për shkarkim sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, përkatësisht nuk ishin përmbushur rrethanat sipas nenit 14, paragrafi 11.

## Çështjet kontestuese

10. Avokati i Popullit vëren se çështje kontestuese është mospërmbushja e kriterëve të përcaktuara në nenin 14, paragraf 11, të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, në

bazë të të cilit, Kuvendi i Republikës së Kosovës mund ta shkarkojë një drejtor të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it.

### Vlerësimi i Avokatit të Popullit


11. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit vëren se çështja e emërimit dhe e shkarkimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it rregullohet me Ligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike.
12. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vëren se Ligji për Energjinë Elektrike, neni 14, paragrafi 11, përcakton:  
*“11. Kuvendi i Republikës së Kosovës mund të shkarkojë një drejtor të Bordit para përfundimit të mandatit të tij/saj në rastet kur anëtari:*
  - 11.1. është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
  - 11.2. nuk është në gjendje shëndetësore të kryejë detyrat e tij/saj për më shumë se tre (3) muaj me radhë; dhe
  - 11.3. nuk merr pjesë në më shumë se pesë (5) mbledhje të njëpasnjëshme, për çfarëdo arsye.”
13. Sipas këtij përcaktimi, Avokati i Popullit vlerëson se neni 14, paragrafi 11, përcakton kushtet për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, pa plotësimin e të cilave nuk mund të bëhet shkarkimi i tyre.
14. Avokati i Popullit konsideron se Kuvendi i Republikës së Kosovës, në rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. 08-V- 063, datë 12 gusht 2021, me të cilin ankuesja ishte shkarkuar nga pozita e anëtares së Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, nuk kishte dhënë sqarime rreth ekzistencës së rrethanave të përcaktuara në nenin 14, paragrafi 11, të Ligjit për Energjinë Elektrike.
15. Më tej Avokati i Popullit, referuar njoftimit të AKK-së drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me rastin e ankueses vëren se mbajtja e pozitës së drejtorit në ASHNA-s krahas ushtrimit të funksionit publik si anëtare e Bordit të Drejtorëve në KOSTT nuk është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, mirëpo ndalesa ekziston sa i përket shpërblimit me pagesë.
16. Sipas mendimit të AKK-së: *“Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.”*
17. Avokati i Popullit vëren se ankuesja personalisht i ishte drejtuar me kërkesë Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për ta shqyrtuar çështjen e pagës së saj si anëtare e Bordit të KOSTT-it, duke respektuar mendimin e AKK-së.
18. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit vlerëson se përfundimi i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, sipas të cilit ankuesja duhet të përcaktohej se cilën pozitë do ta ushtronte, nuk ishte në përputhje me mendimin e AKK-së.
19. Në këtë drejtim Avokati i Popullit vlerëson se Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti i Kuvendit të Republikës së Kosovës do të duhej ta vlerësonte

çështjen e ndalesës së pagesës sipas mendimit të AKK-së dhe t'i propozonte Kuvendit qëndrim konkret lidhur me këtë çështje, në mënyrë që të zbatoheshin në tërësi dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

### **Përfundim**

20. Avokati i Popullit thekson se emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it rregullohet me Ligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, përkatësisht me nenin 14 të këtij ligji.
21. Më tej Avokati i Popullit vlerëson se mbajtja e pozitës së drejtorit në AShNA-s krahas ushtrimit të funksionit publik si anëtare e Bordit të Drejtorëve në KOSTT nuk është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.
22. Avokati i Popullit konsideron se çështja e ndalesës së pagesës, sipas mendimit të AKK-së, do të duhej të shqyrtohej nga Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe të vendosej në seancë plenare nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
23. Avokati i Popullit vlerëson se, në mënyrë që të qartësohet situata lidhur me të drejtat dhe detyrimet e ankueses në rastin konkret, është shumë e rëndësishme që procedura të zhvillohet duke pasur parasysh nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, e po ashtu duke pasur parasysh faktin nëse janë plotësuar kriteret e përcaktuara shprehimisht në nenin 14, paragrafi 11, të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike.

Me nderime,

  
Naïm Qelaj

Avokat i Popullit